



Instituti per Studime Publike & Ligjore



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA LIBRAZH D

NJOFTIM PER SHTYP

Bashkia Librazhd dhe Instituti për Studime Publike e Ligjore organizuan takimin “Modeli Win-Win për Strategjinë dhe Projektet e Zhvillimit të Bashkisë Librazhd” në kuadër të një projekti për Pjesëmarrjen Qytetare në Qeverisjen Vendore, zbatuar nga Instituti i Studimeve Publike e Ligjore dhe financuar nga Ambasada e Zvicrës përmes programit Lëviz Albania.

Takimi, i zhvilluar në Kinoteatrin e Bashkisë Librazhd, solli së bashku kryetarin dhe autoritete të tjera të bashkisë, përfshirë administratorë të njësive vendore e ndërlidhës komunitarë, si dhe përfaqësues nga: bizneset ose organizimet e tyre; organizata jo-fitimprurëse; grupe të ndryshme interesi; individë të shquar në sektorë të caktuar. Bashkia Librazhd është një nga dy bashkitë pilote të përzgjedhura nga projekti për testimin e një shembulli të praktikës së mirë, që mund të replikohet më pas në bashki të tjera.

Projekti, i diskutuar gjatë të takimit, synon të rrisë përfshirjen e drejtpërdrejtë qytetare në vendimmarrjen dhe menaxhimin e programeve dhe projekteve vendore, sipas një modeli të bazuar në një instrument të unifikuar, të adoptuar nga Këshilli i Europës. Modeli që do të aplikohet në formë pilote për një periudhë 1 vjecare në Bashkinë Librazhd synon që të përgatisë Strategjinë afatmesme të Zhvillimit të Bashkisë Librazhd, si dhe të gjenerojë projekte vendore konkrete me interes të gjerë komunitar e me pjesëmarrje qytetare direkte. Projekti pritet të konkludojë me miratimin zyrtar të deri dy projekteve, të hartuara dhe më pas të zbatuara me pjesëmarrje aktive konkrete qytetare, si dhe me përmirësimin e Rregullores së Bashkisë për të mundësuar programimin vendor me pjesëmarrje qytetare në vazhdimësi.

Në takimin e parë në Bashkinë Librazhd, pjesëmarrësit u informuan mbi objektivat, pritshmëritë, dhe metodologjinë e projektit, u shpjegua modeli që do të ndiqet për programimin me pjesëmarrje gjatë zbatimit të tij dhe u hodhën idetë e para të përfaqësuesve të komunitetit mbi vizionin dhe drejtimet strategjike afatmesme të zhvillimit të bashkisë.

Në takim u shpreh mbështetja, angazhimi dhe sugjerime për zbatimin e projektit nga ana e pjesëmarrësve.

Procesi do të vijojë më pas me lëshimin nga ana e Bashkisë Librazhd e një thirrjeje të hapur për paraqitje projektesh drejtuar të gjithë komunitetit, projekte të cilat mund të jenë të financueshme në kuadër të vitit buxhetor 2017. Në vazhdim, propozimet e projekteve do t'i nënshtrohen një procesi renditjeje sipas përparësisë për një rreth sa më të gjerë përfituesish të komunitetit dhe konsultimesh e diskutimesh si për përzgjedhjen e tyre të mëtejshme ashtu edhe për të përgatitur hartimin e Strategjisë afatmesme të Bashkisë Librazhd në harkun kohor të 12 muajve.